

VENDIM
Nr. 294, datë 26.12.2024

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 262, DATË 2.12.2024, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘SLR ALBANIA’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2622 prot., datë 26.12.2024, të Drejtorisë së Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 262, datë 2.12.2024, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘SLR Albania’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 262, datë 2.12.2024, ka vendosur të licencojë shoqërinë “SLR Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Në pikën 2 të këtij vendimi është përcaktuar si kusht se: “Përpara fillimit të operimit, shoqëria ‘SLR Albania’ sh.p.k. të depozitojë në ERE, VNM-në paraprake të re” dhe në pikën 3, përcaktohet se: “Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, brenda afateve të përcaktuara në kontratën me MIE-n”.

- Shoqëria “SLR Albania” sh.p.k. ka dorëzuar më datë 3.12.2024, në adresën zyrtare elektronike të ERE-s, një kopje të vendimit për VNM-në paraprake, të miratuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Ky vendim mban datën 2.12.2024, me nr. serial: AN011020240006 dhe nr. komisioni 158.

- Afati i vlefshmërisë së kësaj VNM-je paraprake përcaktohet si më poshtë vijon:

- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.

- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

- Në këto rrethana, shoqëria “SLR Albania” sh.p.k. ka përmbushur kushtin e përcaktuar në pikën 2, të vendimit nr. 262, datë 2.12.2024, të Bordit të ERE-s, duke dorëzuar një vendim të ri për VNM-në paraprake.

- Bazuar në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili përcakton se: një akt administrativ mund të anulohet ose shfuqizohet kryesisht nga organi publik që ka kompetencën për ta nxjerrë, nga organi i tij epror ose nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj, vlerësojmë se pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 262, datë 2.12.2024, duhet të shfuqizohet, pasi shoqëria “SLR Albania” sh.p.k. ka përmbushur kushtin e vendosur nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 262, datë 2.12.2024, shfuqizohet.
2. Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “SLR Albania” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja

që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti